



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 02.07.2019, ora 10:30

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve datë: 27 maj, 05,06,11 qershor 2019
2. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2018 për projektin “Programi sektorial i ujërave/furnizimi me ujë i zonave rurale IV””

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Roland Xhelilaj, Xhevit Bushaj, Evis Kushi, Senida Mesi, Blerina Gjylameti, Krenar Ryci, Ervin Bushati, Anastas Angjeli, Reme Lala, Artur Roshi, Artemis Dralo (Malo), Vullnet Sinaj, Myslim Murrizi, Ardit Konomi, Dritan Bici dhe Korab Lita.

Mungojnë:

Antoneta Dhima, Edlira Hyseni dhe Nikolin Staka.

Të ftuar:

Artan Shkreli - Zëvendësministër i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë

Lindita Sotiri – Drejtore në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Jovan Gjika - Kordinator i projektit (AKUM)

Leonard Miloti - Kordinator i projektit (FSHZH)

HAPET MBLEDHJA

Arben Ahmetaj – Mirëmëngjesi!

Në rendin e ditës së sotme kemi dy pika.

Pika e parë e rendit të ditës është miratimi i procesverbaleve të datave 27 maj, 05, 06 dhe 11 qershor. I keni pasur në *e-mail*.

A keni ndonjë koment për procesverbalet?

Faleminderit!

Miratohen procesverbalet.

Pika e dytë e rendit të ditës është shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2018 për projektin “Programi sektorial i ujërave/furnizimi me ujë i zonave rurale IV.””

Relatorë e këtij projektligji është deputetja Evis Kushi.

Të ftuar në komision janë: Artan Shkreli, zëvendësministër i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Lindita Sotiri, drejtore, zoti Jovan Gjika dhe zoti Leonard Miloti, kordinator i projektit FSHZH.

Fillojmë me relatimin.

Po, zonja Kushi.

Evis Kushi – Faleminderit, kryetar!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Më falni! E drejtë. Në fund...

Evis Kushi – Marrëveshja, që propozohet të ratifikohet me këtë projektligj, synon sigurimin e financimit të nevojshëm për realizimin e fazës IV të projektit “Furnizim me ujë i zonave rurale”.

Ky projekt mbështetet në prioritetet e përcaktuara në dokumentet strategjike të vendit, siç janë strategjia kombëtare për furnizimin me ujë dhe kanalizimet, si dhe strategjia kombëtare për zhvillim dhe integrim 2015-2020.

Në vijim të këtyre dokumenteve, vitet e fundit sektori i turizmit po arrin përmirësime të ndjeshme sasiore dhe cilësore.

Faza IV e këtij projekti është vazhdimi i rezultateve pozitive të arritura gjatë fazave të mëparshme, përmes së cilave u arrit të përmirësohej furnizimi me ujë për më shumë se 160 fshatra të vendit.

Gjatë fazës IV projekti parashikon kryerjen e investimeve në zonën bregdetare në Jug të vendit, duke u fokusuar në bashkitë e Himarës dhe Orikumit, të cilat janë zona më të rëndësishme turistike dhe kanë potencial për zhvillim të mëtejshëm. Këto investime do të destinohen për përmirësimin e infrastrukturës së ujësjellësve dhe kanalizimeve, konkretisht, për përmirësimin e furnizimit me ujë të pijshëm, si dhe përmirësimin e sistemit të kanalizimeve, të grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura.

Marrëveshja parashikon që Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë të marrë nga qeveria e Republikës Federale e Gjermanisë, nëpërmjet bankës KfW, një kredi të butë, me vlerë të përgjithshme deri në 40 milionë euro për realizimin e projektit, si dhe një grant prej 2 milionë eurosh për masat e nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit.

Kjo marrëveshje është kuadër dhe do të pasohet nga marrëveshjet e financimit, që do të lidhen midis KfW-së dhe marrësve të shumave të financimit.

Agjencia zbatuese e projektit është Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Këshilli i Ministrave është në rolin e garantuesit të kredisë. Financimi për këtë projekt është parashikuar në programin buxhetor afatmesëm 2019-2021 të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në programin “Furnizimi me ujë i zonave rurale IV”.

Kjo marrëveshje pritet të ndikojë në përmirësimin e infrastrukturës turistike dhe të kushteve të jetesës së qytetarëve. Ajo do të sjellë zhvillimin e mëtejshëm të turizmit dhe rritjen e numrit të përfituesve.

Kjo marrëveshje është shprehje e kontributit të rëndësishëm që ka dhënë dhe vazhdon të japë qeveria gjermane për ekonominë e vendit tonë, por edhe e rritjes së aftësisë kredimarrëse të vendit tonë. Kredia do të merret me kushte të buta, prandaj edhe kostoja e saj është e ulët.

Bazuar në këto argumente, u sugjeroj kolegëve të komisionit ta miratojnë këtë projektligj.

Kur të fillojmë diskutimet, kam dy pyetje.

Arben Ahmetaj – Ju nuk i sugjeroni, por i kërkon, si relatore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kërkojani komisionit, pastaj se çfarë do të bëjë komisioni, kjo është histori tjetër!

Faleminderit, zonja Kushi!

Evis Kushi – Unë i sugjeroj...

Arben Ahmetaj – Kërkojani me këmbëngulje.

Evis Kushi – Kërkoja ti, si kryetar.

Arben Ahmetaj – Unë ia kam kërkuar dhe gjithë kohës e kanë dhënë votën.

Evis Kuhsi – Unë kaq i lejoj vetes, pastaj...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Shumë mirë.

Për informacionin e komisionit, kemi dy ndryshime. Zoti Arben Elezi është votuar nga Kuvendi si nënkryetar i këtij komisioni dhe zoti Myslim Murrizi është zëvendësues në këtë komision. Kemi edhe një anëtar të ri, që është Korab Lita.

Faleminderit! Punë të mbarë! Suksese!

Po, zoti Shkreli.

Ju lutem, mos e lexoni relacionin!

Artan Shkreli – Dakord, po i referohem vetëm me *topics*.

Ky është një projektligj që vjen në një moment kur Shqipëria është hapur ndaj turizmit ndërkombëtar dhe turizmi ka atakuar një nga zonat më problematike të furnizimit me ujë, nga njëra anë, dhe impianteve të ujërave të zeza, nga ana tjetër. Është e paimagjinueshme në kushtet ku ndodhemi, që do të thotë një rritje vjetore nga 15-18% e turizmit...

Nuk dëgjohem? Më falni, edhe një herë!

Ky projektligj vjen në një moment shumë delikat për zhvillimin e turizmit në Shqipëri, sepse turizmi, në fakt, është ndërkombëtar. Përveç fluksit që ka pësuar turizmi dy vjetët e fundit, ai është drejtuar në një nga zonat më problematike të Shqipërisë për furnizimin me ujë dhe impiantet e pastrimit të ujërave të zeza. E kemi thënë shpesh dhe duhet ta pranojmë që deri tani ujërat e zeza janë filtruar, në një mënyrë ose në një tjetër, në det, duke ulur cilësinë e resorteve tona turistike.

Ky projektligj synon marrjen e një kredie të butë nga Gjermania. Sasia e kredisë do të përcaktohet pas miratimit të këtij projektligji, që, nga njëra anë, do të bëjë të mundur furnizimin me ujë të të dyja bashkive të mëdha turistike, Himarës dhe Orikutit (Himarës me të gjitha fshatrat deri në Borsh dhe Orikutit me gjithë zonën urbane të tij), dhe, nga ana tjetër, do të sigurojë edhe impiantet e ujit të pijshëm, i cili do të garantohej 24 orë, jo vetëm në ditët e zakonshme, por edhe në momentin e pikut turistik. Kjo është sfida e këtij investimi, që do të bëhet nëpërmjet kësaj kredie.

Për sa u përket kohërave të realizmit, mendohet që... Impianti i Himarës do të mbulojë rreth 36 mijë banorë, si dhe rreth 60 mijë banorë në të gjitha rrethinat, duke përfshirë ose jo, në varësi të sezonit, edhe fluksin turistik.

E njëjta gjë ndodh edhe me impiantin e Orikutit, i cili është pak më i madh dhe mbulon rreth 53 mijë banorë, por rritja turistike e Orikutit nuk është e niveleve të Himarës.

Në qoftë se do të shkojë çdo gjë mbarë, ky projekt është parashikuar të mbarojë brenda vitit 2021 për furnizimin me ujë 24 orë dhe brenda vitit 2022 do të mbarojnë impiantet e pastrimit të ujërave të zeza, të cilat nuk do të filtrohen më nëpër përrrenjtë e fshatrave respektive dhe as në det, natyrisht. Kjo ishte me pak fjalë.

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Shkreli!

Sa ishte shuma dhe interesi, zoti Shkreli?

Artan Shkreli – 40 milionë euro, ndërsa interesi është i butë, por nuk është përcaktuar akoma. Ndoshta ju, meqenëse jeni jo vetëm politikisht, por edhe teknikisht, mund të...

Arben Ahmetaj – Unë e kam negociuar.

Artan Shkreli – Prandaj e thashë.

Arben Ahmetaj - Pyeta ministrinë se mos e kishte ulur interesin.

Artan Shkreli –Jo, do të përcaktohet pas miratimit të këtij projektligji.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Zonja Kushi, kishit disa pyetje, që i kishit bërë gati. Mezi prisnit t’i bënit. Kështu që...

Evis Kushi – Patjetër, se përgatitemi ne.

Arben Ahmetaj – Dakord, por mos e vazhdo këtë, bëj pyetjet!

Evis Kushi – Po, pra, por edhe ju...

Arben Ahmetaj – Bëj pyetjen, zonjë!

Evis Kushi – Patjetër, tani.

Thamë që kjo marrëveshje synon sigurimin e financimit për fazën IV të projektit.

Cilat janë rezultat e arritura deri më sot në fazat e mëparshme të këtij projekti? Si kanë ecur ato? A kemi pasur rezultate pozitive?

Meqenëse kjo fazë është e fokusuar në zonat e bregdetit të Jugut, konkretisht, në Himarë dhe Orikum, a ka parashikime për zonat e tjera të vendit, gjithashtu, bregdetare? A ka faza të tjera më pas ky projekt?

Gjatë auditimit që Kontrolli i Lartë i Shtetit u ka bërë shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve (në përgjithësi, nuk po fokusohem në ndonjë zonë të veçantë) ka konstatuar problematika, që lidhen me çështje të ndryshme, për shembull: niveli i ulët i mbledhjes së detyrimeve nga konsumatorët; shkelje ligjore, që kanë sjellë si pasojë edhe dëme ekonomike në buxhetin e shtetit; ka raste të mospagesave të detyrimeve të energjisë elektrike apo detyrime të tjera tatimore; problematika që lidhen me konfliktin e interesit apo problematika me aparatet matëse të ujit e të tjerë.

Si është aktualisht situata e këtyre problematikave? A janë marrë masa nga këto shoqëri për të zbatuar rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit? Shqetësohemi për këtë, sepse buxheti i shtetit mbulon garancinë e kredisë. Kjo është arsyeja që duam të dimë se si zbatohen këto projekte dhe paratë që marrim hua, si...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Patjetër, ju lutem!

Vazhdo, Vullnet!

Të mblidhen pyetjet dhe pastaj të...

Vullnet Sinaj – Kam një pyetje konkrete. Në relacion nuk shikoj emrat e fshatrave të bashkisë së Himarës, si Kallarat, Vranisht, Bolenë, Tërbaç.

A janë këto fshatra pjesë e këtij projekti të furnizimit me ujë të zonave rurale IV?

Këto janë fshatrat të bashkisë së Himarës, por i përkasin zonës së Labërisë, të lumit të Vlorës. Nuk i pashë të përmendeshin në relacion dhe si deputet i zonës më duhet një informacion, nëse janë apo jo në projekt.

Faleminderit!

Artur Roshi – Çfarë kuptoni ju me kredi të butë? Me çfarë referencash e krahasoni atë, që e quani të butë?

Thatë se jeni në fazën IV të projektit. Cilat janë tri fazat e tjera? Çfarë përfshijnë ato? Për ta bërë më të qartë: cilët impiante? Çfarë mase ose zonash përfshin impianti i furnizimit (edhe i pastrimit, se dëgjova një kakofoni)?

Faleminderit!

Senida Mesi – Përshëndetje të gjithëve!

Zoti Shkreli, të falënderoj për prezantimin!

Në fakt, doja të dija diçka për miratimin e projektit konkret në zonën bregdetare, në Orikum dhe Himarë, nëse projekti i furnizimit me ujë i zonave rurale IV ka të parashikuara edhe zona të tjera të Shqipërisë.

Sigurisht, ne e kemi diskutuar shumë herë që i gjithë territori i Republikës së Shqipërisë, sidomos zonat rurale, por jo vetëm, ka nevojë për investime në infrastrukturën e ujësjellësve, me qëllim që qytetarët të kenë ujë, kushte dhe orare të mjaftueshme, si për ujin e pijshëm, ashtu edhe për përdorim të nevojave të tjera.

Është shumë e rëndësishme të kuptojmë, edhe si deputetë, nëse ky projekt përfshin edhe zona të tjera.

Nëse këto zona nuk janë të përfshira, me lejen e kryetarit, do të kërkoj të bëjmë një shkresë, me qëllim që të kemi një plan edhe për zonat e tjera bregdetare, siç e tha edhe zonja Kushi, por jo vetëm.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj - ...koment për këtë të fundit, por ndoshta ka të bëjë pak me pyetjen e zotit Roshi.

Ky është programi i katërt. Në fakt, kanë qenë tri programe të tjera, një pjesë e të cilave janë ende në vazhdim. Dy pjesët e para kanë përfunduar plotësisht. Kurse e treta është në përfundim. Ka qytete të rëndësishme në të gjithë Shqipërinë, duke filluar nga qyteti i Gjirokastrës deri në zonat e veriut. Në mos gabohem, Gjirokastra kishte programe deri në 4-5 milionë euro dhe ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka rëndësi. Aty afër është, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Leonard, a është Gjirokastra te programi 3?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si thua “nuk është e përfshirë”, kur ti merresh përditë me atë punë? Në mos gabohem, janë 4,2 milionë euro.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është në programin 3.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këtë po them.

Zoti Roshi, janë përfshirë shumë qytete.

Zonja Senida, sugjerimi im është t’i bëjmë një shkresë specifike qeverisë për interesin e zonave të përcaktuara jo vetëm për programin, por për të gjithë kuadrin e investimeve publike në infrastrukturën ujore. Flas për investimet në total nga buxheti, që të mos i referohemi një programi të vetëm.

Zoti Shkreli, ju lutem!

Artan Shkreli – Për sa i përket pyetjes së parë, meqenëse zoti Leonard është përfaqësues i Fondit Shqiptar të Zhvillimit, mendoj se ai duhet të japë disa specifikime për atë që u kërkua nga relatori.

Leonard Miloti – Faleminderit!

Janë tri programe të mëparshme që kanë filluar në vitin 2009 dhe janë në vazhdim. Programi i parë dhe i dytë janë implementuar në vitet 2009-2011, ndërsa programi i tretë i

ujësjellësve ruralë, që është në proces, ka filluar në vitin 2015. FSHZH-ja ka bërë një fushatë sensibilizuese në vitin 2015 me të gjitha bashkitë dhe i ka listuar të gjitha nevojat që ato kanë pasur. Pas përfundimit të këtij procesi në të gjitha bashkitë e vendit, është përgatitur një shortlistim i kërkesave që kanë dalë dhe është bërë fizibiliteti. Para një viti ka përfunduar projekti për një pjesë të madhe të skemave, të cilat janë ndarë në të gjithë territorin e vendit në 4 lote, sipas rajoneve.

Konkretisht, në Korçë në lotin 1 janë fshatrat: Kamenicë, Dvoran; vazhdon në Devoll, në Përrenjas.

Loti 2 është në Klos, në Mat, në Tropojë, në Lezhë dhe në Dibër.

Loti 3 është në Vlorë, në Dukatë, në Tragjas.

Në Himarë është pjesa e skemës që merr uji nga një burim i pavarur në Kuç, Buronjë.

Në Fier dhe në Lushnjë është ujësjellësi i Çifligut.

Në Berat dhe në Urë Vajguore është Pashalli-Gurë i Bardhë.

Në Tiranë janë fshatrat Zall-Bastar, Zall-Dajt, Shëngjin, Besh.

Në Durrës është një pjesë e Shkëmbit të Kavajës sipër shinave, zona e Katundit të Ri dhe ish-ferma e Xhafzotajt.

Këto janë skemat fituese me të cilat ka filluar zbatimi i punimeve të programit 3. Në total, në programin 3 janë 85 mijë përfitues dhe 83 fshatra, çka është mbi normat që ka pasur marrëveshja e financimit.

Për sa i përket pyetjes për impiantet dhe zonat e ndërhyrjes, programi 4 parashikon vetëm impiante për trajtimin e ujërave të ndotura, jo ujit të pijshëm. Uji i pijshëm merret nga burimet e Kuçit, që është 18 kilometra larg Himarës dhe parashikon furnizimin e zonës së bregut, përfshi Pilurin, Kuçin dhe zonën e bregut nga Borshi deri në Palas.

Për ta sqaruar, Palas, Gjilekë, Iliaz dhe Dhërmi nuk janë pjesë e programit për t'u financuar aktualisht, por sasia e ujit është llogaritur deri te depot sipër tyre. Fshatrat që përfitojnë direkt nga ky program janë: Jala, Vunoi, Himara Fshat, Livadhia, Piluri, Kudhësi, Qeparoi dhe Borshi. Fizibilitetet e këtij programi janë përgatitur nga kompania konsulentë në tetor të vitit të shkuar dhe shpresojmë që projektimi të fillojë këtë vit.

Artan Shkreli – Doja të shtoja se fizibiliteti merr parasysh edhe zhvillimet turistike në breg, jo vetëm fshatrat në vetvete, të cilat ndodhen mbi zonën bregdetare. Kur flasim për Dhërmiun, flasim për zonat e Drimadhës apo për Dhërmiun plazh, duke pasur parasysh edhe masterplanet që janë miratuar kohët e fundit nga qeveria me intensitetet përkatëse, për aq kohë sa ne mund të parashikojë flukset turistike në të ardhmen e afërt.

Për sa i përket pyetjes së dytë, po ia kaloj fjalën zonjës Sotiri, e cila do të flasë edhe për sa i përket pyetjes për Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe për masat e marra në raport me AKU-në.

Lindita Sotiri – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti zëvendësministër!

Në kuadër të pyetjes së bërë nga deputetja Kushi, siç e dini edhe ju, furnizimi me ujë dhe trajtimi i ujërave të ndotura është funksion i drejtpërdrejtë i bashkisë, por Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, duke qenë se udhëheq reformën në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, po e monitoron në mënyrë të vazhdueshme performancën e shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve. Fondi i subvencionimit të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve, ndaj të cilit ne kemi tagër të drejtpërdrejtë të ushtrimit të auditimit, është rritur nga dy vjet më parë, nga një shifër 4 milionë euro në 7 milionë euro. Ajo që kemi synuar të arrijmë për të nxitur performancën e shoqërive 1 miliard lekë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, 1 miliard...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Për mbulimin e kostove...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kërkoj ndjesë për përdorimin e monedhës!

Siç e tha edhe kryetari i komisionit, 1 miliard lekë janë ndarë, 400 prej të cilave mbulojnë drejtpërdrejt kostot dhe 600 milionë janë shpërndarë në sajë të performancës së shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve. Çfarë është bërë vitin e kaluar? Janë lidhur kontrata performance me të gjithë kryetarët e bashkive, që secili prej tyre të ndërgjegjësohet për detyrën që ka për të monitoruar dhe për të nxitur performancën e shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve. Kanë qenë 15 indikatorë të përcaktuar ndaj të cilëve është bërë një rankim.

Arben Ahmetaj – Më falni, zonjë!

Ju pyeti për Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Lindita Sotiraj – Patjetër.

Arben Ahmetaj – Ju përmendi shifrën që ujësjellësit kanë detyrim ndaj OSHEE-së.

Mos kaloni te performanca, sepse është një element brenda reformës dhe përgjegjshmërisë! Fokusohuni te pyetja për KLSH-në!

Lindita Sotiraj – Faleminderit!

Por, mendojmë se performanca ndikon drejtpërdrejt në rritjen e të ardhurave të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve, dhe këto të ardhura do të kontribuojnë në uljen e borxhit

që shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve kanë ndaj OSHEE-së. Kështu, ne do të kemi rezultate konkrete edhe falë aksionit që kemi ndërmarrë vitin e kaluar, ku falë përgjigjes së qytetarëve...

Arben Ahmetaj – Kam një pyetje për ju, zonja Sotiri, meqë iu referuat aksionit: sa nga lekët shtesë shkuan për shlyerjen e borxheve të vjetra? Ia kam bërë këtë pyetje edhe ish-ministrit Gjiknuri.

Lindita Sotiri – Në total, falë aksionit të udhëhequr nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, u mbledhën 22 milionë euro. Në shifra konkrete mund të themi se shoqëria e Ujësjellës-Kanalizimeve në Vlorë mbulon debitin ndaj OSHEE-së ...

Arben Ahmetaj – Zonjë, kërkoj ndjesë!

Ju bëra një pyetje specifike: sa nga paratë e mbledhura shtesë shkuan për shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve dhe jo për paga apo për shpenzime të tjera?

Lindita Sotiri – Shifrën ekzakte ...

Arben Ahmetaj – Unë e di shifrën, por duhet ta dijë komisioni.

Lindita Sotiri - Nuk e kam shifrën ekzakte për momentin, por di t'ju them se ujësjellësi i Vlorës tashmë po shlyen detyrimet; ujësjellësi i Durrësit i ka përgjysmuar detyrimet dhe pagesën aktuale.

Arben Ahmetaj - Sa?

Lindita Sotiri – Nuk e kam me vete shkresën.

Arben Ahmetaj – Nga 1,5 miliardë në sa?

Lindita Sotiri – Gjysma, 7,5 miliardë.

Arben Ahmetaj –Jeni e sigurt?

Lindita Sotiri – Po.

Arben Ahmetaj – Ju lutem, na e dërgoni shkresën me shkrim, sepse zonja Kushi do që ta ketë nga ministria juaj!

Lindita Sotiri – Patjetër.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Po, zoti Shkreli.

Artan Shkreli - Për sa u përket fshatrave Kallarat, Vranisht, Tërbaç janë zona të Labërisë, por me ndarjen e re administrative bëjnë pjesë në Bashkinë e Himarës.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, zoti Vullnet.

Ky projekt nuk i përfshin këto fshatra, por fokusohet kryesisht në zonën bregdetare, në lokalitetet që kanë të bëjnë me turizmit. Pra, në njëfarë mënyre do të përfitojnë fshatrat që

për veçoritë morfologjike dhe fizike që kanë, përballojnë një fluks turistik. Në fakt, ujësjellësit apo impiantet e ujërave të zeza nuk janë të llogaritura për numrin mesatar të lokaliteteve apo të fshatrave, por për numrin turistik, i cili është disa herë më i madh. Këto fshatra nuk përfshihen në këtë projekt, por janë në masterplanin makro, që do të jetë në investimet e mëvonshme. I vetmi fshat i thellë që përfshihet është Kuçi, sepse uji merret pranë fshatit Buronjë, që është lagje e Kuçit. Të gjitha zonat e tjera janë në vijën bregdetare.

Për sa i përket pyetjes së zotit Roshi, se ç'kuptojmë me kredi të butë, unë nuk jam në gjendje ta them shifrën konkrete të interesit të kredisë, e cila do të përcaktohet pas miratimit të projektligjit, por besoj se zoti Ahmetaj, nga eksperiencia, mund të na thotë diçka të përafërt, se çfarë do të thotë në shifra konkrete norma e interesit të mosmiratimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ndoshta, nuk jam i bindur.

Arben Ahmetaj - Faleminderit, zoti Shkreli!

Për sa i përket pyetjes suaj ndaj meje për normën e interesit, do t'ia dërgoj komisionit me shkrim. Meqë zoti Shkreli më pyeti, do t'i përgjigjem me shkrim.

Në fakt, qeveria vjen këtu për të dhënë llogari, jo unë, sepse jam kryetar i komisionit, por mund të jap llogari me kënaqësi para qeverisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Shkreli, nuk ju kam dhënë leje të flisni.

Ka pyetje të tjera?

Urdhëroni!

Myslim Murrizi – Faleminderit, zoti kryetar!

Meqenëse jam prezent për herë të parë në komision, dua të di çfarë vlerash totale kanë kreditë e marra nga viti 2009 deri sot për projektet 1, 2 dhe 3? Sa është shuma totale e tyre?

E dyta, duke u nisur nga përgjigjja që Leonardi i dha kryetarit të komisionit për projektin 3, që thotë se është miratuar, por nuk ka filluar zbatimin...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kështu ishte, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për Gjirokastrën?

Po projektet 1 dhe 2 kanë boshllëqe, si projekti 3, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, miratojmë projektet 1,2, 3, 4 dhe i lëmë të pazbatuara. A kanë përfunduar projektet 1 dhe 2? Po thoni se Gjirokastra është e pambaruar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Shikoj se kredia e fundit është 42 milionë euro. Në raportin shpjegues thuhet se 40 milionë janë borxh dhe 2 milionë janë grant. Për 80 mijë banorë, të cilëve do t'u hyjnë në punë dy ujësjellësit e dy bashkive, janë gati 525 euro për qytetar. Cili është afati i shlyerjes së kësaj kredie, sepse e pash që interesin nuk e dinit dhe ia kërkuar kryetarit?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk thashë se nuk e dini ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Zoti Shkreli.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Murrizi, kur drejtoni seancën si nënkryetar, nuk më lejoni mua të debatoj pa leje.

Myslim Murrizi – Shikoj një paragraf ku thuhet: "...për këtë arsye, përcaktimi përfundimtar që do të bëhet, do të jetë investimi në Himarë dhe do t'i nënshtrohet një studimi fizibiliteti të financuar nga qeveria gjermane, studim i cili ka përfunduar në muajin dhjetor të vitit 2018". Do t'i nënshtrohet, apo ka përfunduar?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Domethënë ka mbaruar?! Se po lexoj këtë që keni shkruar këtu.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Kam një sqarim për ju. Praktikisht 3-shi edhe në afatet e parashikuara kohore është akoma brenda limiteve të veta kohore, pra nuk është se i ka përfunduar. Besoj se zoti Shkreli e përmendi momentin 1, që kapacitetet janë të parashikuara me progresionin e rritjes së popullsisë, por edhe me rritjen e turizmit. Pra, logjika juaj për 525-523 euro, më vjen keq ta them, por nuk është referencë e saktë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord janë 83 mijë banorë, por nuk është e saktë ajo që ju bëni për banor. Logjika është që në atë zonë, ku referohet kredia, bëhet fjalë për shumëfishim gati në 3-4 fish.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bëhet fjalë për turizmin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Normal, kjo është e saktë për banorët që preken nga projekti, ndërsa vizitorët janë me herë më shumë, kur bëhet fjalë për ato zona.

Po, zoti Shkreli.

Artan Shkreli – Doja të thosha që në studimin e fizibilitetit, të cilin mund t’jua vë në dispozicion, përcaktohet shumë qartë se normativa e ujit për banor është më e lartë se normativa në fshatrat e tjerë, pasi një pjesë shumë e madhe e shtëpive që përdoren në këtë zonë jepen me qira gjatë verës me dhoma, që do të thotë se sasia e ujit që konsumohet në 24 orë është disa herë më e madhe se sasia e ujit që konsumohet në fshatrat, të cilat nuk kanë fluks të shtuar gjatë verës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, kanë shumë më tepër banorë në shtëpi. Nëse një shtëpi normale ka 4 banorë, gjatë kohës së fluksit turistik shkon deri në 16 vetë, të cilët shfrytëzojnë ujin gjatë ditës dhe dihet që gjatë verës bëjnë dush 2- 3 herë në ditë pasi kthehen nga plazhi. Një herë në javë lahen ata të zonave të thella malore, ku natyrisht konsumi i ujit është më i pakët.

Për sa i përket pyetjes së zotit Murrizi, se sa ka qenë vlera e investimit për fazat e tjera, po them që në tri fazat e para ka qenë 51,6 milionë euro. Faza e parë ka kushtuar 11,6, kurse dy fazat e tjera kanë kushtuar 40 milionë euro.

Arben Ahmetaj – A ka pyetje të tjera?

Artan Shkreli – Faleminderit!

Kam një pyetje që lidhet me projektin. Duke qenë se te materiali pashë që fokusohet më shumë tek ujësjellës-kanalizimet sesa te impianti i trajtimit të ujërave, doja të dija a përfshihen këto te studimi i fizibilitetit apo te mënyra si është konceptuar projekti? Shqetësimi im është që, në rast se rritet konsumi i ujërave të bardha, natyrisht që rritet dhe shkarkimi i ujërave gri të ndotura dhe në zona me specifika dhe ndjeshmëri të lartë turistike si këto, mund të shkaktojnë probleme mjedisore dhe probleme me turizmin.

Ardit Konomi – Unë mund të flas për këtë fazë të projektit, sepse e kam ndjekur, kurse për fazat e tjera mund të flasim të tjerët. Ato janë projekte të bëra paralel dhe konsulenti i fizibilitetit ka qenë i njëjtë, që do të thotë se janë bërë referenca. Meqenëse flitet për të njëjtat fshatra, çështja e impianteve të pastrimit, dekompostimit të ujërave të zeza dhe të momentit, kur bashkohen me ujërat e bardha (në ato seksione ku bashkohen), janë bërë në funksion të furnizimit me ujë të pijshëm, pra janë marrë në konsideratë flukset e reja.

Arben Ahmetaj – Faleminderit për pyetjet!

Besoj se e ezauruat komplet informacionin. Nëse keni pyetje për ministrinë, ju lutem bëjini me shkrim!

Mendoj të kalojmë në votimin në parim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, patjetër.

Vullnet Sinaj –Në bazë të përgjigjes që më dha zoti Shkreli, që 4 fshatrat e Lumit të Vlorës, si Kallarati, Vranishti, Bolena dhe Tërbaçi, janë jashtë këtij projekti, është pak e vështirë për mua si deputet i maxhorancës të diskutoj dhe për hatër të atyre banorëve atje unë nuk ndihem mirë. Pra të bëjmë një investim për 80 mijë banorë në Himarë, kur ajo sot ka 25 mijë banorë (flasim edhe për pjesën e Orikumit) dhe të lëmë 4 fshatrat jashtë një projekti, nuk më duket normale. Kemi vendosur vetëm Kuçin dhe Buronjatin atje ku merret ujë, pra shkojmë në Lumin e Vlorës në Labëri, ua marrim ujin e pijshëm dhe furnizojmë të gjithë fshatrat e bregdetit. Jam dakord të furnizohen, pasi janë fshatra turistikë, ku do të shkojnë turistë dhe ndikon në zhvillimin e ekonomisë, por nuk mund të lihen 4 fshatra jashtë këtij studimi. Ju thoni që studimi i fizibilitetit është bërë nga banka gjermane. Do të vikan gjermanë të studiojnë fizibilitetin në vendin tonë? Do të lëmë 4 fshatrat e zonës së Himarës pa ujë? Për mua nuk është normale, sepse është një investim që po bëhet në rrugën e Lumit të Vlorës.

Fondi i Investimeve po e ndjek investimin, i cili kushton mbi 100 milionë euro e, nga ana tjetër, qeveria kërkon të zhvillojë turizmin atje, si bujtina etj. Si do të shkojnë turistë atje kur nuk ka ujë, nuk ka kushte? Si qenka bërë ky plan fizibiliteti, kur lihen jashtë 4 fshatra të një bashkie? Nuk është normale. Unë do të kërkoja programin e ujësjellësit rural 4, që ta dija si është bërë studimi, për të kuptuar pse janë lënë ato 4 fshatra.

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Vullnet!

Dua të theksoj se qeveria gjermane, nëpërmjet KfW-së, në kombinim me grant dhe kredi, ka hartuar 4 programe për sektorin e ujit, nga i cili ka përfituar qyteti i Vlorës, tani futen Orikumi dhe Himara, dy bashki të qarkut të Vlorës. Ndërkohë Selenica ka mbaruar fazën e parë dhe kërkon fazën e dytë nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, që do të thotë se, në bazë të mundësive të buxhetit të shtetit, ashtu si Vlorën, që, si qark ngelet prioritet për shkak të turizmit dhe zhvillimit ekonomik, do të fusë edhe bashki të tjera Shqipëri, që kanë problematikë të njëjtë të ujërave të bardha dhe të zeza.

Faleminderit!

A ka ndonjë koment tjetër?

Po, zoti Roshi.

Artur Roshi – Në përgjithësi, kur bëhet fjalë për marrje kredish, ndryshon vetëm forma. A i merrni nga bankat, apo nga privatët? Si duket kjo është një sëmundje kronike e qeverisë suaj. Qytetarët duan të dinë se cili është impakti i këtij investimi? Për sa kohë ai kthehet mbrapsht? Sa përfitojnë nga turizmi? Këto janë gjëra që duhet të shqetësojnë çdo qytetar, por të paktën ne, si pjesë e politikës, duhet t'i ngremë këto pyetje. Në raport me

projektet nuk jemi të qartë. A janë të përfshira brenda impiantet e pastrimit nëse marrim Orikumin? Kemi impiantin e furnizimit, ndërkohë që këtu përfshihet edhe impianti i pastrimit. Pra kemi njërin dhe nuk kemi tjetrin?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull, do të thotë se ka një logjikë unike nga projektuesit.

Ne shohim që qeveria është e shpërndarë dhe nuk e di qëllimin pse i merr këto kredi dhe ku i çon. Nuk e ka të qartë çfarë do të thotë investim, vetëm e di që i duhen paratë. Mënyra si i prish ato lë për të dëshiruar.

Arben Ahmetaj - Faleminderit!

Kam një koment për zotin Roshi, se besoj se do t'i duhet. Do t'ju vë në dispozicion dy dokumente: dokumentin e zhvillimit të sektorit, si ka qenë, si është dhe ku kanë shkuar paratë, dhe dokumenti i dytë është për efektivitetin e borxhit. Në kohën e PD-së dhe Ballit Kombëtar për 1 lek të marrë borxh, investoheshin 1,18 lekë. Në kohën e PS-së (Rama qëndro edhe për disa mandate!) për 1 lek të marrë borxh investohet 1,74 lekë.

Këtë ta them që të kuptosh se çfarë efektiviteti ka borxhi.

Zoti Shkreli, do t'ju lutesha, që t'i vinit zotit Roshi në dispozicion edhe fizibilitetet, që të kuptojë dhe të qartësohet se ku shkojnë paratë, për çfarë shkojnë dhe çfarë rentabiliteti kanë! Kur të sillni studimet e fizibilitetit, ju lutem të bashkëngjitni edhe dokumentin statistikor, që tregon për rritjen e turizmit dhe rritjen e të ardhurave kombëtare nga turizmi nga 900 milionë euro në 2,7 miliardë euro në vitin 2018!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, se ka rregulla në komision! Nuk ka gjë. Ma sqaroni më vonë, zoti Haka!

Kalojmë në votimin në parim.

Kush është dakord?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Vazhdojmë në votimin nen për nen.

Kush është dakord me nenin 1?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet

Kush është dakord me nenin 2?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Kush është dakord?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!

Do ta kalojmë menjëherë në seancë, që të fillojnë investimet.

Ditën e mirë!

Mirupafshim!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësjë e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti